



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

2509

128/1



Balkan Cities Network

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E QEVERISJES ELEKTRONIKE DHE INOVACIONIT
KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. D-14109 prot.

Tiranë, më 27/09/2024

Lënda: 2 Kthim përgjigje

Z. DORIAN MATLIJA

Bulevardi "Gjergj Fishta", godina 24, hyrje 3, ap. 7, Tiranë

I nderuar z. Matlija,

Pranë Bashkisë së Tiranës, bazuar në ligjin 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" është paraqitur kërkesa juaj, e cila është protokolluar me nr. prot. D-14109, datë 03.09.2024 dhe ka kaluar për shqyrtim pranë Komisionit të Posaçëm për Vlerësimin dhe Përzgjedhjen e Subjekteve Përfituese nga Programet e Procesit të Rindërtimit, e cila ka kthyer përgjigje me shkresën me nr. D-14109/1 prot., datë 23.09.2024, si më poshtë vijon:

"Në vijim të shkresës së sipërcituar, ku keni kërkuar dokumentacion në lidhje me listat e procesit të rindërtimit ju bëjmë me dije se:

Në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga parashikimet e vendimit nr. 904, datë 24.12.2019, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit", të ndryshuar vendimit nr. 5, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model", të ndryshuar, Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë, për përcaktimin e strukturave përgjegjëse për secilën fazë të procesit të rindërtimit.

Komisioni i Posaçëm, shqyrton dhe vlerëson aplikimet me nivel dëmi DS1, DS2, DS3, DS4, DS5, sipas dokumentacionit të paraqitur në fazën e aplikimit, të përcjella nga drejtoritë përgjegjëse, të cilat koordinojnë me Njësitë Administrative dhe Lagjet e Bashkisë Tiranë, dhe në vijim nëpërmjet Raporteve Përmbledhëse të miratuara nga Kryetari, për të vijuar më tej me propozimin për miratim nga Këshilli Bashkiak, si organ vendimmartës.

Bashkëlidhur po ju dërgojmë një kopje të njësuar të Raportit Përmbledhës nr. 32810, datë 22.09.2023, miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 112, datë 15.11.2023".

Sa më sipër lutemi në dijeninë tuaj.

Me respekt

KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Blarta G. G. G.



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

BASHKIA TIRANË

**KOMISIONI I POSAÇËM I SHQYRTIMIT DHE VLERËSIMIT TË APLIKIMEVE PËR
TË PËRFITUAR NGA PROGRAMET E PROCESIT TË RINDËRTIMIT**

Nr. 32810

Tiranë, më 22.09, 2023

**RAPORT PËRMBLEDHËS
PËR SHQYRTIMIN DHE VLERËSIMIN E APLIKIMEVE PËR PROGRAMET E
PROCESIT TË RINDËRTIMIT**

Drejtuar:

Z. Erion Veliaj
Kryetar

Nëpërmjet:

Komisionit të posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e subjekteve
përfituese nga programet e procesit të rindërtimit

Z. Rezart Sulstarova

Kryetar

Znj. Loreta Shelu

Anëtar

Znj. Nensi Bardha

Anëtar

Znj. Alba Metoja

Anëtar

Z. Kostandin Budurushi

Anëtar

Lënda:

Informacion i përgjithshëm në lidhje me ecurinë dhe përfundimin e
shqyrtimit dhe vlerësimin të 158 aplikimeve, për të përfitur nga
programet e procesit të rindërtimit.

Data:

22.09.2023

I nderuar zoti Kryetar,

Sikurse jeni në dijeni, tërmeti i fuqishëm i rënë në datën 26.11.2019, që tronditi Shqipërinë, përfshiu edhe territorin administrativ të Bashkisë Tiranë, ku janë evidentuar dëme të shumta ndërtimore në të gjitha Njësitë Administrative në juridiksionin administrativ të saj. Nisur nga kjo ngjarje natyrore, e cila krijoi një situatë të papritur me pasoja të rënda për banorët e Bashkisë Tiranë, duke cënuar sigurinë e tyre dhe shkaktuar dëme të mëdha për jetën e njerëzve, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 750, datë 27.11.2019, "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë", të ndryshuar, në të cilin ishte sanksionuar fakti se për përballimin dhe lehtësimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe

Lezhë, institucionet publike ishin të detyruara të merrnin masa të jashtëzakonshme për përballimin e kësaj situatë. Konkretisht, referuar pikës 7.1, shkronjat "a" dhe "d" institucionet publike duhej të realizonin plane masash organizative dhe administrative për përballimin e gjendjes së fatkeqësisë natyrore dhe ndihmojnë në përballimin dhe lehtësimin e saj.

Në vijim, Këshilli i Ministrave, me qëllim intensifikimin e masave dhe veprimeve për përballimin e pasojave të kësaj fatkeqësie natyrore, si edhe të fatkeqësive të tjera që për shkak të intensitetit, të shkallës dhe të shtrirjes së tyre, kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme të të gjitha institucioneve të mbrojtjes civile, miratoi Aktin Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, i cili ka si objekt kryesor të rregullojë funksionimin e organeve përgjegjëse për rehabilitimin dhe rindërtimin e komuniteteve dhe të territoreve të prekura nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, si dhe zhvillimin e territoreve të reja, duke përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, programet e procesit të rindërtimit, funksionimin e fondit të rindërtimit dhe procedurat përkatëse.

Referuar parashikimeve të nenit 17, të këtij akti, Bashkia Tiranë, si një prej njësive të vetëqeverisjes vendore që pësoi shumë dëme nga tërmeti i datës 26 Nëntor 2019, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen civile dhe planifikimin dhe zhvillimin e territorit, ka për detyrë të:

- a) administrojë fondet që transferohen nga Këshilli i Ministrave prej fondit të rindërtimit, përfshi dhe kontributet në natyrë, kur caktohen si njësi zbatuese me vendim të Këshillit të Ministrave;
- b) miratojnë planet e detyruara vendore, planet e detajuara vendore dhe lejet e zhvillimit e të ndërtimit, në funksion të procesit të rindërtimit;
- c) krijojë, administrojë dhe përditësojë bazën e të dhënave për individët dhe familjet që kanë humbur familjarë dhe/ose kanë mbetur të pastrehë si pasojë e fatkeqësisë natyrore, si dhe plotësimin e nevojave të tyre nga programet e procesit të rindërtimit;
- ç) të mund të krijojnë zyra të posaçme për rindërtimin, me qëllim mirëmenaxhimin e procesit të rindërtimit në nivel lokal etj.

Në zbatim të këtyre parashikimeve dhe në funksion të fillimit të zbatimit të programeve të procesit të rindërtimit, Këshilli i Ministrave miratoi një sërë aktesh në zbatim të Aktit Normativ, në të cilat u detajuan procedurat që duhet të ndiqen për secilin prej programeve, nga të cilat, më të rëndësishmet mund të përmendim vendimin nr. 904, datë 24.12.2019, "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit", të ndryshuar.

Vendimet e sipërcituara, krahas përcaktimit të procedurave dhe rregullave për të përfituar nga disa prej programeve të lartpërmendura, parashikojnë detyrimin e kryetarit të bashkisë për ngritjen e një komisioni të posaçëm që do të vlerësojë dhe shqyrtojë aplikimet për të përfituar nga programet e procesit të rindërtimit. Më specifikisht, detyrat konkrete të komisionit janë të përcaktuara në pikat e poshtëshënuara:

- Pika 16, e VKM-së nr. 904/2019: "Për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit, në bazë të kritereve të përcaktuara në këtë vendim dhe listës së objekteve të vëna në dispozicion nga organi përgjegjës shtetëror, kryetari i njësive të vetëqeverisjes vendore, ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, krijon një komision të posaçëm, i cili vlerëson kërkesat e subjekteve që përfitojnë nga programet e procesit të rindërtimit, në bazë të dokumentacionit përkatës dhe parashikimeve të këtij vendimi, si dhe harton listën e subjekteve që përfitojnë nga programet e procesit të rindërtimit.

- Pika 21, e VKM-së nr. 5/2020: "Për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programi i granteve të rindërtimit, në bazë të kritereve të përcaktuara në këtë vendim, kryetari i njësive të vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore ose autoriteti përgjegjës krijon një komision të posaçëm, i cili vlerëson kërkesat në bazë të dokumentacionit të kërkuar, sipas këtij vendimi."

Në zbatim të parashikimeve të pikave të lartpërmendura, kryetari i Bashkisë miratoi urdhrin nr. 11408/1, datë 25.03.2020, "Për krijimin e Komisionit të Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e subjekteve përfituese nga programet e procesit të rindërtimit", i ndryshuar, në përbërje të të cilit ka përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Sociale, Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile, Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit Financiar, Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit Financiar, Drejtorisë së Përgjithshme Juridike, Aseteve dhe Licencimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, si njësitë organizative kryesore të aparatit të Bashkisë Tiranë, fusha e përgjegjësisë së të cilave lidhet drejtpërdrejt me procesin e rindërtimit. Njëkohësisht, në pikën 4 të këtij urdhri është parashikuar fakti se Komisioni i Posaçëm, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij asistohet nga Sekretariati Teknik, i cili përbëhet nga përfaqësues të drejtorive pjesë e komisionit dhe që ka si detyra kryesore kontrollimin e dosjeve të çdo aplikanti sipas dokumentacionit që vërteton deklaratimet e bëra në momentin e aplikimit; dhënien e mendimit kur i kërkohet nga komisioni, mendim i cili pasqyrohet në procesverbalin e mbledhjes; mban, harton dhe nënshkruan procesverbalin e mbledhjes, zbardh vendimin e arsyetuar të marrë në mbledhjen e Komisionit etj.

Më tej, në funksion të mbarëvajtjes normale të punës dhe përmbylljes me sukses të procesit të rindërtimit, si dhe në kuadër të synimit të Bashkisë Tiranë për të detajuar hapat që duhet të ndiqen nga secila strukturë e Bashkisë Tiranë, e krijuar për procesin e rindërtimit, Këshilli Bashkiak miratoi vendimin nr. 70, datë 12.06.2020, "Për miratimin e udhëzuesit "Për detajimin e procedurave për të përfituar nga programet e procesit të rindërtimit".

Në vija të përgjithshme, ky udhëzues operacional ka parashikuar faktin se procedura për shqyrtimin e dokumentacionit të depozituar nga aplikuesit, e përcjellë nga Njësitë Administrative/Lagjet respektive kalon në dy faza: Faza e parë e aplikimit, konsiston në aplikimin e individëve dhe/ose familjeve, që kanë pësuar dëme në banesat e tyre nga tërmeti i datës 26 Nëntor 2019, të paraqesin kërkesën e tyre pranë njësive administrative/lagjeve përkatëse ku ata kanë vendbanimin. Njësitë administrative dhe lagjet pas plotësimit të formularëve dhe dokumentacionit të kërkuar, i përcjellin ato pranë strukturave përgjegjëse të Bashkisë Tiranë. Në varësi të statusit të shkallës së dëmtimeve të pasqyruara në formularin e aplikimit, aplikimet e klasifikuara si DS1; DS2 dhe DS3, i përcillen nga Njësia Administrative/Lagjia, Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile (në vijim DPOBANJAEC), ndërsa për aplikimet e klasifikuara si DS4 dhe DS5, i përcillen Drejtorisë së Përgjithshme e Shërbimeve Sociale (në vijim DPSHS) dhe në bazë të Urdhrit të Kryetarit me nr. 42541, datë 01.12.2022 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së institucionit të Bashkisë Tiranë", aplikimet e klasifikuara si DS1, DS2, DS3, DS4 dhe DS5 i përcillen nga Njësia Administrative/Lagjia, Drejtorisë së Koordinimit Monitorimit Bashkërendimit të Rindërtimit (në vijim DKMBR).

Faza e dytë e procesit fillon me shqyrtimin paraprak nga ana e DPSHS dhe DKMBR të dosjeve të ardhura nga Njësitë Administrative/Lagjet. Dosjet që paraqiten me mangësi në formularë apo dokumentacion, i dërgohen Njësive administrative/lagjeve, me qëllim njoftimin e aplikantit dhe plotësimin e mangësive brenda 7 ditëve. Nëse në përfundim të këtij afati, aplikuesi nuk depoziton informacionin e kërkuar, ai humbet të drejtën që dosja e tij të shqyrtohet në vijim për të përfituar nga programet e procesit të rindërtimit.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Koordinimit Monitorimit Bashkërendimit të Rindërtimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile, nëpërmjet shkresave me nr. 20386/5, datë 27.07.2023, nr. 20386/1, datë 13.06.2023, nr. A-9855/3, datë 30.06.2023, nr. 2483, datë 19.01.2021, nr. 15284/1, datë 02.05.2023, nr. 14223, datë 06.04.2021, nr. 16027, datë 16.04.2021, nr. 13795, datë 01.04.2021, nr. 23727/3, datë 29.08.2022, nr. 2596, datë 19.01.2021, nr. 28939, datë 22.07.2021, nr. 36050/1, datë 13.10.2022, kanë përcjellë pranë Sekretariatit

Teknik dosjet e individëve/familjeve të cilët kanë aplikuar për të përfituar nga programet e procesit të rindërtimit.

Me anë të shkresës me nr. 31606 prot., datë 13.09.2023, Komisioni i Posaçëm ka njoftuar mbledhjen në datën 18.09.2023 e në vijim, për shqyrtimin e dosjeve të deponuara për të përfituar nga programi i grantit të rindërtimit. Ndodhur në këto kushte, Sekretariati Teknik është mbledhur për të kontrolluar dosjet e përcjella me shkresat përkatëse të sipërcituara. Në përfundim të përmbushjes së këtij detyrimi, Sekretariati Teknik, me anë të shkresës me nr. 31606/1 prot., datë 15.09.2023 i ka vendosur në dispozicion Komisionit të gjitha praktikatat e kontrolluara për secilin aplikues, duke shpjeguar të gjitha problematikat përkatëse.

Komisioni, në përmbushje të detyrave dhe përgjegjësi që i ngarkojnë vendimet e Këshillit të Ministrave dhe urdhri përkatës i kryetarit të Bashkisë, ka mbajtur procesverbalin përkatës në të cilin ka pasqyruar problematikat e dosjeve të caktuara, diskutimet dhe vendimmarrjet për çdo aplikim, duke dhënë arsyetimet përkatëse në lidhje me to.

Duke marrë për bazë ndryshimet më të fundit të pikës 8, të Kreut II, të vendimit nr. 5, datë 06.01.2020, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model", e miratuar me vendimin nr. 879, datë 11.11.2020, të Këshillit të Ministrave, në të cilin përcaktohet se vlcra e grantit që do të përfitohet për ndërtimin e shtëpive individuale do të përcaktohen me vendim të Këshillit Bashkiak, ky organ detajoi vlerat përkatëse dhe procedurat për përfitimin e grantit të rindërtimit, me vendimin nr. 160, datë 07.12.2020, "Për përcaktimin e vlerave për përfituesit e grantit të rikonstruksionit/rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar nga akt-ekspertizat e thelluara të Institutit të Ndërtimit me nivel dënesh DS4 dhe DS5", të ndryshuar.

Gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të dosjeve, por në të njëjtën kohë duke mbajtur në konsideratë edhe mendimet e propozimet e Sekretariatit, Komisioni përgjatë kësaj periudhe ka arritur të shqyrtojë dhe vlerësojë dosjet e qytetarëve dhe në përfundim të shqyrtimit të tyre vendosi:

MBI PRAKTIKAT E APLIKUESVE PËR NËNPROGRAMIN E GRANTIT TË RIKONSTRUKSIONIT, BANESAT E TË CILËVE JANË KLASIFIKUAR NGA AKT EKSPERTIZAT E THELLUARA TË INSITUTIT TË NDËRTIMIT ME NIVEL DËMI DS4:

- I. Kualifikimin si të rregullta, në total të 1 (një) aplikimi, të dërguar me anë të shkresës me nr. 28079, datë 04.08.2023, nga Nënkryetaria e Bashkisë Tiranë, përkatësisht, vendimi mbi ankimimin e paraqitur nga qytetari me nr. 27725, datë 01.08.2023, për tu rishqyrtuar nga Komisioni i Posaçëm, pasi praktika plotëson kriteret dhe kushtet e përcaktuara në dispozitat ligjore që rregullojnë procesin e rindërtimit, sipas listës nr. 1, e cila përmban titullin "Lista emërore e Ankimimeve të pranuar DS4", bashkëlidhur këtij raport.

Gjithashtu, Komisioni i Posaçëm propozon për miratim si subjekt përfitues z. Nexhip Qose, me nr. aplikimi 22718, pasi me anë të shkresës së ardhur nga Organi Ankimor, me nr. M-8837/3, datë 06.06.2023, është përcjellë për tu rishqyrtuar, pranë Komisionit të Posaçëm, kërkesa e qytetarit, z. Nexhip Qose me status DS4, Njësia Administrative Nr. 6 (aplikimi i të cilit është hequr nga lista e përfituesve të VKB 7/2021, sipas Raportit Përmbledhës me nr. 44607, datë 25.01.2023, me arsyen se prona e tij ndodhet brenda zonës së re për zhvillim, referuar informacionit të dërguar nëpërmjet shkresës me nr. 10403/5, datë 31.05.2021, nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit), bashkëlidhur kësaj shkresë z. Qose ka deponuar lejen e ndërtimit me nr. A-768/2 si dhe kthim përgjigjen me nr. N-4186, datë 19.04.2021 nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, e cila e njofton se territori ku ndodhet banesa e tij nuk është subjekt hartimi i Planit të Detajuar Vendor.

Informacionin më të detajuar e gjeni sipas listës nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij raporti.

- II. Skualifikimin në total të 4 (katër) aplikimeve, nga të cilat 3 (tre) aplikime të shqyrtuara për herë të parë dhe 1 (një) ankimim i dërguar nga Nënkryetarja e Bashkisë Tiranë nëpërmjet shkresës me nr. 19607, datë 24.05.2023 pranë Komisionit të Posaçëm për rishqyrtim, konkretisht vendimi me nr. 19269, datë 22.05.2023, në lidhje me ankimimin administrativ të paraqitur nga qytetari dhe pas rishqyrtimit të praktikave nga Komisioni, nuk u kualifikuan si të rregullta, pasi nuk përmbushin kriteret ligjore të parashikuara në dispozitat që rregullojnë procesin e rindërtimit dhe këtë informacion e gjeni sipas listës nr. 2, me titull "Lista emërore e subjekteve të skualifikuara DS4", e cila përfshin "Lista emërore e Ankimimeve të Skualifikuara DS4", bashkëlidhur këtij raporti.

MBI PRAKTIKAT E APLIKUESVE PËR NËNPROGRAMIN E GRANTIT TË RINDËRTIMIT, DS5:

- I. Kualifikimin si të rregullta, në total të 8 (tetë) aplikimeve, nga të cilat 1 (një) aplikim i shqyrtuar për herë të parë dhe 7 (shtatë) ankimime të paraqitura nga qytetarët dhe të dërguara nëpërmjet shkresave me nr. 19606, datë 24.05.2023, nr. 19608, datë 24.05.2023, nr. 28079, datë 04.08.2023 dhe nr. 28079, datë 04.08.2023 nga Nënkryetarja e Bashkisë Tiranë për rishqyrtim, konkretisht vendimet nr. 19268, datë 22.05.2023, nr. 19265, datë 22.05.2023, nr. 19262, datë 22.05.2023, nr. 19259, datë 22.05.2023, nr. 27720, datë 01.08.2023, nr. 27721, datë 01.08.2023 dhe nr. 27726, datë 01.08.2023, pasi praktikat plotësojnë kriteret dhe kushtet e përcaktuara në dispozitat ligjore që rregullojnë procesin e rindërtimit, sipas listës nr. 3, e cila përmban titullin "Lista emërore e Subjekteve Përfutuese DS5" dhe "Lista emërore e Ankimimeve të pranuar DS5", bashkëlidhur këtij raporti.
- II. Skualifikimin në total të 10 (dhjetë) aplikimeve, nga të cilat 9 (nëntë) aplikime të shqyrtuara për herë të parë dhe 1 (një) ankimimi të dërguar nga Nënkryetarja e Bashkisë Tiranë nëpërmjet shkresës me nr. 19608, datë 24.05.2023, pranë Komisionit të Posaçëm për rishqyrtim, konkretisht vendimi nr. 19263, datë 22.05.2023, në lidhje me ankimimin administrativ të paraqitur nga qytetari dhe pas rishqyrtimit të praktikës nga Komisioni, nuk u kualifikua si e rregullt, pasi nuk përmbush kriteret ligjore të parashikuara në dispozitat që rregullojnë procesin e rindërtimit dhe këtë informacion e gjeni sipas listës nr. 4, me titull "Lista emërore e subjekteve të skualifikuara DS5", e cila përfshin "Lista emërore e Ankimimeve të Skualifikuara DS5", bashkëlidhur këtij raporti.

MBI PRAKTIKAT E APLIKIMEVE TË NËNPROGRAMIT TË RINDËRTIMIT TË NDËRTESAVE TË PREKURA NGA FATKEQËSIA NATYRORE, PJESË E PROGRAMIT TË ZHVILLIMIT TË OBJEKTEVE TË REJA:

- I. Kualifikimin si të rregullta, në total të 53 (pesëdhjetë e tre) aplikimeve, nga të cilat 45 (dyzetë e pesë) aplikimeve të shqyrtuara për herë të parë, të Njësisë Administrative Nr. 4, Nr. 6 dhe 8 (tetë) ankimime të dërguara nëpërmjet shkresave me nr. 21740, datë 09.06.2023, nr. 19605, datë 24.05.2023, nr. 19608, datë 24.05.2023, nga Nënkryetarja e Bashkisë Tiranë për rishqyrtim pranë Komisionit, konkretisht nr. 21382, datë 07.06.2023, nr. 21381, datë 07.06.2023, nr. 19267, datë 22.05.2023, nr. 19257 datë 22.05.2023, nr. 19264 datë 22.05.2023, nr. 19250 datë 22.05.2023, nr. 19255, datë 22.05.2023, nr. 19260, datë 22.05.2023, pasi praktikat plotësonin kriteret dhe kushtet e përcaktuara në dispozitat ligjore që rregullojnë procesin e rindërtimit dhe këtë informacion e gjeni sipas listës nr. 5, me titull "Lista emërore e subjekteve përfutuese (Programi i zhvillimit të objekteve të reja)", e cila përfshin dhe Lista emërore e

ankimimeve të pranuar (Programi i zhvillimit të objekteve të reja)", bashkëlidhur këtij raporti.

- II. Skualifikimin në total të 72 (shtatëdhjetë e dy) aplikimeve, nga të cilat 71 (shtatëdhjetë e një) aplikime të shqyrtuara për herë të parë dhe 1 (një) ankimim i dërguar nga Nënkryetarja e Bashkisë Tiranë nëpërmjet shkresës me nr. 21740, datë 09.06.2023 pranë Komisionit të Posaçëm për rishqyrtim, konkretisht vendimi nr. 21380, datë 07.06.2023, në lidhje me ankimimin administrativ të paraqitur nga qytetari dhe pas rishqyrtimit të praktikave nga Komisioni, nuk u kualifikuan si të rregullta, pasi nuk përmbushin kriteret ligjore të parashikuara në dispozitat që rregullojnë procesin e rindërtimit, dhe këtë informacion e gjeni sipas listës nr. 6, me titull "Lista emërore e skualifikimeve (Programi i zhvillimit të objekteve të reja)", e cila përfshin "Lista emërore e Ankimimeve të Skualifikuara (Programi i zhvillimit të objekteve të reja)", bashkëlidhur këtij raporti.

Gjithashtu, me anë të shkresave me nr. 20861/1, datë 13.06.2023 dhe nr. 20242, datë 30.05.2023, pranë Komisionit të Posaçëm janë përcjellë disa gabime materiale të evidentuara në të dhënat e subjekteve përfitues përkatësisht, në të dhënat e qytetarit Ervin Hysni Deda, Njësia Administrative Zall Bastar, shpallur fitues me nr. rendor 303, në VKB 174/2020, në të dhënat e qytetarit Qazim Ali Aliu, Njësia Administrative Zall Bastar, shpallur fitues me nr. rendor 325 në VKB 174/2020, në të dhënat e qytetarit Hajrije Ismail Allmuça, Njësia Administrative Vaqarr, shpallur fitues me nr. rendor 156 në VKB 24/2022. Informacioni gjendet në listën nr. 7, bashkëlidhur këtij raporti.

Në zbatim të vendimit të gjykatës, përkatësisht vendimi me nr. 1097(80-2020-1124), datë 08.04.2022, si dhe në vijim të detyrimeve që rrjedhin nga urdhri i Kryetarit, përkatësisht me nr. 2168/1, datë 01.02.2023, për kryerjen e procedurave për ekzekutimin e vendimeve, bashkëlidhur këtij raporti, Komisioni dërgon për miratim si përfitues nga programi i grantit të rindërtimit, z. Rexhep Sulejman Vogli (Sanie/Renald Vogli), me status DSS, Njësia Administrative nr. 1.

Në zbatim të vendimit nr. 2125, datë 18.07.2022 dhe urdhrit të kryetarit nr. 20344/1, 14.06.2023, dërgon për miratim si përfitues nga programi i grantit të rindërtimit, z. Agron Nevruz Dine me status DSS, Njësia Administrative nr. 9. Në zbatim të vendimit nr. 817, datë 16.03.2022 dhe urdhrit të kryetarit nr. 22227/1, datë 27.06.2023, dërgon për miratim si përfitues nga programi i grantit të rindërtimit, z. Arjan Adem Murati me status DSS, Njësia Administrative Kashar.

Në zbatim të vendimeve të gjykatës përkatësisht, vendimi me nr. 923, datë 25.04.2022, si dhe në vijim të detyrimeve që rrjedhin nga urdhri i Kryetarit përkatësisht me nr. 21207/1, datë 27.06.2023, për kryerjen e procedurave për ekzekutimin e vendimeve, bashkëlidhur këtij raporti, Komisioni dërgon për miratim si përfitues nga programi i zhvillimit të objekteve të reja, z. Artan Abdulla Tabaku (Liljana/Mateo/Anxhelo Tabaku), me status DSS, Njësia Administrative Nr. 6, si përfitues nga programi i zhvillimit të objekteve të reja. Në zbatim të vendimeve të gjykatës përkatësisht, vendimi me nr. 301, datë 20.02.2023, si dhe në vijim të detyrimeve që rrjedhin nga urdhri i Kryetarit, përkatësisht me nr. 15444/1, datë 31.05.2023, për kryerjen e procedurave për ekzekutimin e vendimeve, bashkëlidhur këtij raporti, Komisioni dërgon për miratim si përfitues nga programi i zhvillimit të objekteve të reja, z. Loli Ylli Jaupaj, me status DSS, Njësia Administrative Nr. 6, si përfitues nga programi i zhvillimit të objekteve të reja.

Në zbatim të vendimit me nr. 2687 datë 17.10.2022, si dhe në vijim të detyrimeve që rrjedhin nga urdhri i Kryetarit përkatësisht me nr. 11445, datë 21.03.2023, për kryerjen e procedurave për ekzekutimin e vendimeve, bashkëlidhur këtij raporti, Komisioni dërgon për miratim si përfitues nga programi i zhvillimit të objekteve të reja, z. Sose Azis Hoxha, me status DSS, Njësia Administrative Nr. 6, si përfitues nga programi i zhvillimit të objekteve të reja, me strukturë 3+1. Informacioni gjendet në listën nr. 8, bashkëlidhur këtij raporti.

Gjithashtu, në vijim të informacionit të dërguar nga Drejtoria Koordinimit Monitorimit Bashkërendimit të Rindërtimit dhe Zëvendëskryetarja e Bashkisë Tiranë, me anë të shkresave me nr. 13180/2, datë 14.04.2023, nr. A-26578/2, datë 23.11.2022, dhe nr. 23862/1, datë 19.07.2023,

pranë Komisionit të Posacëm janë dërguar praktikat e rivlerësuara të qytetarëve në bazë të akt ekspertizave të hartuara nga Instituti i Ndërtimit, përkatësisht për praktikën e z. Astrit Çullhaj, i cili rezulton përfitues me status DS3, me nr. rendor 1375, Njësia Administrative Baldushk në VKB 98/2020, për praktikën e z. Jonuz Lita, i cili rezulton përfitues me status DS4, me nr. rendor 9, Njësia Administrative Dajt në VKB 175/2020, për praktikën e znj. Lutfije Pasho, me status DS2, me nr. rendor 720, Njësia Administrative Nr. 5 në VKB 98/2020, Komisioni vendosi përfshirjen e tyre si përfitues sipas nivelit të rivlerësuar të dëmit. Informacioni gjendet sipas listës nr. 9, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij raporti.

Gjithashtu, me anë të shkresës me nr. 1318/2, datë 14.04.2023 nga Drejtoria e Koordinimit Monitorimit Bashkërendimit të Rindërtimit, pranë Komisionit të Posacëm është dërguar praktika e rivlerësuar e qytetarit dhe në këto kushte, aplikimi i z. Jonuz Lita me status DS4, me nr. rendor 9, Njësia Administrative Dajt, hiqet nga lista e përfituesve të VKB 175/2020, për të vijuar më tej procedurat për nivelin e dëmit të rivlerësuar.

Këtë informacion e gjeni sipas listës nr. 10, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij raporti.

Sa më lart dhe duke u bazuar në legjislacionin në fuqi, e më konkretisht në nenin 112, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, parashikohet se organi publik, në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korrigojë gabimet e shkrimit, gabimet në përlllogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ, Komisioni pasi ka verifikuar dokumentacionin përkatës për këto raste vendosi ndryshimin e vendimeve të programeve të procesit të rindërtimit.

Gjithashtu, në rastet kur janë konstatuar disa aplikime nga disa bashkëpronarë për të njëjtën pronë dhe Njësitë Administrative nuk rezultojnë të kenë lëshuar vërtetimin që në këtë banesë në momentin e ndodhjes së fatkeqësisë natyrore ka jetuar edhe një familje/ individ tjetër, Komisioni vendosi shpallje e të gjitha familjeve si përfituese të një apartamenti të vetëm, duke marrë si bazë për përcaktimin e strukturës së banesës, përbërjen familjare të familjes që ka numrin më të madh të anëtarëve në certifikatën familjare.

Në lidhje me aplikantët përfitues, vlerat konkrete financiare të grantit të rindërtimit, do të vendosen në bazë të vlerave të përcaktuara në tabelën e pikës 1, të vendimit nr. 160, datë 07.12.2020, të Këshillit Bashkiak.

Për rrjedhojë, në përfundim të arsytimit dhe argumentimeve të lartpërmendura, si dhe në zbatim të përcaktimit të pikave 16-17, të vendimit nr. 904, datë 24.12.2019, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit", të ndryshuar dhe pikës 22, të vendimit nr. 5, datë 06.01.2020, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model", të ndryshuar, po ju paraqesim për informim dhe miratim këtë Raport Përmbledhës me qëllim vijimin e procedurave të mëtejshme që parashikojnë aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që rregullojnë përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore.

Gjithashtu, ju informojmë se në respektim të parashikimeve përkatëse të shkronjës "dh", të pikës 23, të VKM-së nr. 5/2020, si dhe urdhrin nr. 11408/1, datë 25.03.2020, të kryetarit të Bashkisë aplikantët jofitues kanë të drejtë që brenda 5 ditëve nga data e njoftimit, të paraqesin ankesë pranë organit ankimor të Bashkisë Tiranë.

- 1- Z. Rezart Sulstarova
- 2- Znj. Loreta Shehu
- 3- Znj. Nensi Bardha
- 4- Znj. Alba Metoja
- 5- Z. Kostandin Budurushi

Kryetar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Lista Nr. 1

"Lista emërore e Ankimimeve të pranuar DS4"

Nr.	Njesia	DS	Emet	Atesi	Mbiemri
1	Dajt	DS4	Alban	Kujtim	Qordja
2	Njesia 6	DS4	Nexhip	Idris	Qose

Lista nr. 2

"Lista emërorit e subjekteve të shkollitruara DS4"

Nr.	Njësia	Niveli/ Dëmit.	Emri	Abetja	Mbëmbet.
1	Njësia 10	DS4	Eurej	Ipa	Matoshi
2	Njësia 10	DS4	Xhemal	Mekmet	Abazi
3	Njësia 2	DS4	Arjan	Ismajl	Costurani (Arjan Costurani)

"Lista emërorit e Ankimimeve të shkollitruara DS4"

Nr.	Njësia	Niveli/ Dëmit.	Emri	Abetja	Mbëmbet.
4	Shëngjerësi	DS4	Kimete	Ismail	Hida

Lista nr. 3

"Lista emërORE e Subjekteve Përfuturse DSS"

Nr.	Mjesia	DS	Emër	Atesi	Mblenjer
1	Kashar	DSS	Agim	Ibrahim	Kamberi

"Lista emërORE e Anëtarëve të pranuar DSS"

Nr.	Mjesia	DS	Emër	Atesi	Mblenjer
2	Farke	DSS	Nadire	Aziz	Shehi
3	Farke	DSS	Refail	Vesel	Xhabati
4	Farke	DSS	Shkëlqim	Rustem	Qordia
5	Farke	DSS	Mafmut	Ramazan	Alldevishi
6	Farke	DSS	Sulejman	Shaqir	Balla
7	Baldushk	DSS	Halit	Sulejman	Cullhaj Ferati (Vasip Ferati)
8	Dajit	DSS	Shkëlqim	Sabedini	

Lista nr. 4					
"Lista emërave e Sulljeleve të shkollës DSS"					
Nr.	Njësia	D/S	Emër	Alesi	Mbiemër
1	Dajt	DSS	Hasan	Shyqri	Dervishi
2	Njësia 10	DSS	Mir	Sheqer	Meksi
3	Njësia 10	DSS	Jurgen	Dajram	Kurti
4	Njësia 10	DSS	Arben	Sheqer	Meksi
5	Njësia 10	DSS	Diamond	Myslek	Shalca
6	Njësia 10	DSS	Beqir	Daut	Hysa
7	Njësia 10	DSS	Koze	Ramadan	Zheqiri
8	Njësia 10	DSS	Arant	Llambi	Xhemllari
9	Njësia 10	DSS	Tauti	Çaqo	Xhoro
"Lista emërave e Anëtarëve të shkollës DSS"					
Nr.	Njësia	D/S	Emër	Alesi	Mbiemër
10	Njësia 9	DSS	Bajare	Shaban	Çuka

Lista nr. 5

"Lista emërore e subjekteve përfutuese (Programi i zhvillimit të objekteve të reja)"

Nr.	Njesia	Emër	Atësi	Mbiemër
1	Njesia 6	Hazbije	Osman	Sejko
2	Njesia 6	Bajame / Gentjan	Hyzen / Enver	Mustafa
3	Njesia 6	Ernira / Guri / Dhurata / Artan	Brasim / Ali / Ali / Ali	Gërmenji
4	Njesia 5	Bukurije / Artur / Sokol	Brahim / Eshref / Eshref	Roshi
5	Njesia 6	Bashkim	Skënder	Hyzeni
6	Njesia 6	Altin	Skënder	Krasniqi
7	Njesia 6	Bledar	Tosun	Islamaj
8	Njesia 4	Hasan	Myslim	Sulejmani
9	Njesia 4	Engjellushë	Qerim	Guçe
10	Njesia 4	Mirnoza	Gani	Koçefi
11	Njesia 4	Andrea	Jorgo	Çipi
12	Njesia 4	Artur	Fuat	Korimani
13	Njesia 4	Ndue	Dod	Gjini
14	Njesia 4	Agron	Fejzo	Canaj

15	Njesia 4	Egerem	Helit	Xhezar
16	Njesia 4	Skënder	Abdulla	Kolçini
17	Njesia 4	Meriban	Adem	Tulja
18	Njesia 4	Nurije	Zijni	Nazifi
19	Njesia 4	Qako	Peci	Tase
20	Njesia 4	Artan	Feti	Çeçaj
21	Njesia 4	Agron	Rasip	Orhani
22	Njesia 4	Spartak	Halim	Beqiri
23	Njesia 4	Derrihane	Kasem	Bregu
24	Njesia 4	Vladimir	Çaqe	Çiqolli
25	Njesia 4	Ylli	Hamit	Sharra
26	Njesia 4	Ardian	Ramazan	Islami

27	Njesia 4	Erzen	Sazan	Keta
28	Njesia 4	Habib	Rakip	Cenaj
29	Njesia 4	Irena	Nebip	Balla
30	Njesia 4	Atin	Habib	Cenaj
31	Njesia 4	Gëzim	Sail	Sefa

32	Njesia 4	Grigor / Gentian	Petrit / Grigor	Likaj
33	Njesia 4	Fatmir	Ali	Sakollari
34	Njesia 4	Sajmir / Lefteri	Edmond / Zaim	Xheka
35	Njesia 4	Agim	Petrit	Likaj
36	Njesia 4	Mirmoza	Hasan	Sula

37	Njesia 4	Sokol	Selim	Lazaj
38	Njesia 4	Mimoza	Bashkim	Sefa
39	Njesia 4	Refat	Petrit	Likaj
40	Njesia 4	Hymete	Muhamet	Brahimi
41	Njesia 4	Pagor	Demir	Malushi

42	Mjesia 4	Laver	Petrit	Likaj
43	Mjesia 4	Selim	Zenun	Lazaj
44	Mjesia 4	Kujtim	Mynyr	Velej
45	Mjesia 4	Luiza / Tefia / Fatmir	Ramadan / Ahmet / Ramadan	Karafili

Lista emërore e ankimitëve të pranuarra (Programi i zhvillimit të objekteve të re

Nr.	Mjesia	Nr. aplikimi	Emri	Atesi
46	Mjesia 5	13968	Mustafa	Adem
47	Mjesia 5	9265	Xhemal	Arif
48	Mjesia 5	17996	Orinda	Kujtim
49	Mjesia 5	24590	Irís	Gani
50	Mjesia 6	6153	Viktor	Tofi
51	Mjesia 6	17787	Dervish	Ibrahim
52	Mjesia 6	23216	Tahir	Bardhyl
53	Mjesia 6	39363	Sanije	Ferdinand

Lista nr. 6

"Lista emigrantëve shkollimorë (programi i zivillimit të objekteve të reja)"

Nr	Njësia	Pallati nr.	Emri	Atezi	Mobiliteti
1	Njësia 6	153	Zana	Meharrem	Rashini
2	Njësia 6	158	Lulzim	Ferit	Xhachaj
3	Njësia 6	153	Lindita	Mersim	Tarja
4	Njësia 6	149	Afrim	Skender	Isaku
5	Njësia 6	160	Andi	Semin	Taku
6	Njësia 6	160	Ilir	Skender	Hyseni
7	Njësia 6	160	Luan	Adem	Elez
8	Njësia 6	152	Gavinete	Qazim	Mazreku
9	Njësia 6	152	Bujar	Ali	Mazreku

10	Njësia 6	152	Sokol	Ali	Mazrek
11	Njësia 6	130	Raf	Redon	Vide
12	Njësia 6	130	Santiago	Edoard	Durajlliu
13	Njësia 6	159	Agron	Qarim	Banaj
14	Njësia 6	146	Mateo	Aldo	Luti
15	Njësia 6	146	Saklje	Halte	Çaco
16	Njësia 6	146	Edmond	Figret	Çare
17	Njësia 6	157	Agron	Daut	Uja
18	Njësia 6	145	Shkelqim	Sejdim	Gjinka
19	Njësia 6	145	Elvana	Sejdim	Gjinka

20	Njësia 6	145	Rajmonda	Beqir	Raqif
21	Njësia 6	141	Kristina	Lutfi	Lutfi
22	Njësia 6	174	Hana	Fil	Shula
23	Njësia 6	151	Agron	Petrit	Hysejns
24	Njësia 4	Nr. 37 Rr. "Halit Bega"	Xhender	Aji	All
25	Njësia 4	Godina Ish-Shkollë Komunalet Rr. "Fitrore Rexha"	Mysesjen	Sali	Selmanaj
26	Njësia 4	Godina Ish-Shkollë Komunalet Rr. "Fitrore Rexha"	Ramazan	Hasan	Hyrroj
27	Njësia 4	Godina Ish-Shkollë Komunalet Rr. "Fitrore Rexha"	Renato	Berti	Dhioj
28	Njësia 4	Godina Ish-Shkollë Komunalet Rr. "Fitrore Rexha"	Shpëtim	Nevluz	Islami
29	Njësia 4	Godina Ish-Shkollë Komunalet Rr. "Fitrore Rexha"	Bilal	Ramazan	Idrizi

30	Njesia 4	Godina Ish- Shkollia Kommunale Rr. "Fitnete Rexha"	Berri	Ferik	Dhi'aj
31	Njesia 4	Godina Ish- Shkollia Kommunale Rr. "Fitnete Rexha"	Uri	Hamdi	Ekhal
32	Njesia 4	Godina Ish- Shkollia Kommunale Rr. "Fitnete Rexha"	Tefia	Kaxem	Ujmi
33	Njesia 4	Godina Ish- Shkollia Kommunale Rr. "Fitnete Rexha"	Ibrahim	Muharem	Isufi
34	Njesia 4	Godina Ish- Shkollia Kommunale Rr. "Fitnete Rexha"	Floresha	Syrja	Haxhi
35	Njesia 4	Godina Ish- Shkollia Kommunale Rr. "Fitnete Rexha"	Klodian	Agron	Haxhi
36	Njesia 4	Godina Ish- Shkollia Kommunale Rr. "Fitnete Rexha"	Mjiftim	Pesit	Aliu
37	Njesia 4	Godina Ish- Shkollia Kommunale Rr. "Fitnete Rexha"	Bedrie	Sinan	Mariqa
38	Njesia 4	Godina Ish- Shkollia Kommunale Rr. "Fitnete Rexha"	Berfjar	Ramazan	Islami

39	Njesia 4	Godina Ish- Shkolla Kommunale Rr. "Fitnete Rexha"	Edlira	Shqyri	Shylla
40	Njesia 4	Godina Ish- Shkolla Kommunale Rr. "Fitnete Rexha"	Arjanit	Petric	Ukaj
41	Njesia 4	Godina Ish- Shkolla Kommunale Rr. "Fitnete Rexha"	Sorila	Beljam	Rushrd
42	Njesia 4	Godina Ish- Shkolla Kommunale Rr. "Fitnete Rexha"	Migena	Jehë	Islami
43	Njesia 4	Godina Ish- Shkolla Kommunale Rr. "Fitnete Rexha"	Ebon	Isuf	Uka
44	Njesia 4	Godina Ish- Shkolla Kommunale Rr. "Fitnete Rexha"	Marre	Ibrahim	Furcana
45	Njesia 4	Godina Ish- Shkolla Kommunale Rr. "Fitnete Rexha"	Xhufca	Basim	Hians
46	Njesia 4	Godina Ish- Shkolla Kommunale Rr. "Fitnete Rexha"	Fotjan	Deman	Uoha

47	Njesia 4	Godina Ish-Shkolla Komunalne Rr. "Fitnete Rexha"	Alban	Ali	Zeqiri
48	Njesia 4	Godina Ish-Shkolla Komunalne Rr. "Fitnete Rexha"	Manjola	Kastriot	Bicija
49	Njesia 4	Godina Ish-Shkolla Komunalne Rr. "Fitnete Rexha"	Majlinda	Xhemal	Scollari
50	Njesia 4	Godina Ish-Shkolla Komunalne Rr. "Fitnete Rexha"	Myfete	Shyqiri	Likaj
51	Njesia 4	Godina Ish-Shkolla Komunalne Rr. "Fitnete Rexha"	Sulejman	Ramazan	Islami
52	Njesia 4	Godina Ish-Shkolla Komunalne Rr. "Fitnete Rexha"	Sonila	Gjigjor	Likaj
53	Njesia 4	Godina Ish-Shkolla Komunalne Rr. "Fitnete Rexha"	Merrila	Bujar	Shira
54	Njesia 4	godina Ish-Shkolla Komunalne Rr. "Fitnete Rexha"	Agron	Kasem	Haxhi
55	Njesia 4	Godina Ish-Shkolla Komunalne Rr. "Fitnete Rexha"	Eschkm	Soft	Ramazan
56	Njesia 4	Godina Ish-Shkolla Komunalne Rr. "Fitnete Rexha"	Lufqja	Muharehem	Lika

57	Njësia 4	Godina Ish- Shkollë Kommunale Rr. "Fitnete Rexha"	Myyhyllje	Haxhi	Abazi
58	Njësia 4	Godina Ish- Shkollë Kommunale Rr. "Fitnete Rexha"	Luan	Riza	Topuzi
59	Njësia 4	Godina Ish- Shkollë Kommunale Rr. "Fitnete Rexha"	Samet	Laver	Likaj
60	Njësia 4	Godina Ish- Shkollë Kommunale Rr. "Fitnete Rexha"	Ardiata	Ibrëhim	Dako
61	Njësia 4	Godina Ish- Shkollë Kommunale Rr. "Fitnete Rexha"	Haxhira	Hamdi	Hysa
62	Njësia 4	Godina Ish- Shkollë Kommunale Rr. "Fitnete Rexha"	Mërsina	Turk	Hoxi
63	Njësia 4	Godina Ish- Shkollë Kommunale Rr. "Fitnete Rexha"	Jerranir	Areffi	Xhyvdollari
64	Njësia 4	Godina Ish- Shkollë Kommunale Rr. "Fitnete Rexha"	Fatmir	Adem	Lilaj
65	Njësia 4	Godina Ish- Shkollë Kommunale Rr. "Fitnete Rexha"	Hilmet	Fatmir	Elmazi

"Lista emfjort e Anëtarëve të Shoatësuar (Programi i zhvillimit të objekteve të reja)"					
Nr.	Njësia	Fallesi	Emër	Aksi	Mbieret
72	Njësia 6	154	Erion	Subi	Mari
66	Njësia 4	Godina Ish-Shkollë Komunale Rr. "Fitëre Rexha"	Florian	Agon	Haxhi
67	Njësia 4	Godina Ish-Shkollë Komunale Rr. "Fitëre Rexha"	Urije	Haxhi	Abazi
68	Njësia 4	Godina Ish-Shkollë Komunale Rr. "Fitëre Rexha"	Artida	Veli	Nazja
69	Njësia 4	Godina Ish-Shkollë Komunale Rr. "Fitëre Rexha"	Alina	Edmond	Sula
70	Njësia 4	Godina Ish-Shkollë Komunale Rr. "Fitëre Rexha"	Ornelo	Eduard	Gora
71	Njësia 4	Godina Ish-Shkollë Komunale Rr. "Fitëre Rexha"	Esa	Thoma	Lena

Lista nr. 7

Nr.	Nj.A.	VKB	Nr. nrë VKB	Emri / ArBësia Mbiemëri	Lloji / gabënie		Kohëzgjatja / gabënie
					Ishtirë	Person	
1	Zall Basha	17/4/2020	303	Ervin Hysni Deda			
2	Zall Basha	17/4/2020	325	Qasim Ali Allu			
3	Vaqar	24/2022	156	Hafije Ismail Allmuga	Hall		Ismail

Lista nr. 8

DSS

Nr.	Njësia Administrative	Niveli Dënor	Emri i Aktit Ndihmës	Shtresa referuese
1	Njësia 1	DSS	Rekord Sulqënar Vogël (Sanje / Bernard Vogël)	Nr. 2168/I, 01.02.2023 Urdhër Kryetarit, për përmbushjen e detyrimit që lind nga stulli ekzekutiv të vendimit.
2	Njësia 9	DSS	Agron Ngarur Dine	Nr.20344/I, date 14.05.2023 Urdhër Kryetarit, për përmbushjen e detyrimit që lind nga stulli ekzekutiv të vendimit.
3	Kashar	DSS	Ajten Adem Murati	Nr. 22227/I, date 27.06.2023 Urdhër Kryetarit, për përmbushjen e detyrimit që lind nga stulli ekzekutiv të vendimit.

Njësia Administrative nr. 6 (Programi i zhvillimit të objekteve të reja)

Nr.	Njësia Adm.	Nr. pallat	Emri i Aktit Ndihmës	Shtresa referuese
4	Njësia 6	153	Artan Abdulla Tabaku (Uljana/Mateu/Anshelo Tabaku)	Nr. 21207/I, date 27.06.2023 Urdhër Kryetarit, për përmbushjen e detyrimit që lind nga titulli ekzekutiv të vendimit. Aplikimi në emër të z. Artan Tabaku (i dli ka ndërruar jete.)
5	Njësia 6	108/2	Loli VIII Jaupaj	Nr. 15444/I, date 31.05.2023 Urdhër Kryetarit, për përmbushjen e detyrimit që lind nga titulli ekzekutiv të vendimit.

Ndriçim strukturë pallat Njësia 6 (Programi i zhvillimit të objekteve të reja)

Nr.	Njësia Adm.	Nr. pallat	Emri	Shtresa referuese
6	Njësia 6	140	Sose Aziz Hoxha	Nr. 11445, date 21.03.2023 Urdhër Kryetarit, për përmbushjen e detyrimit që lind nga titulli ekzekutiv të vendimit.

Lista Nr. 9

Rivërësime DS4

Nr.	Njesia	Emer	Atesi	Mbiemri
1	Baldushk	Asrit	Faik	Çulhaj

Rivërësime DS5

Nr.	Njesia	Emer	Atesi	Mbiemri
2	Dajt	Jonuz	Ramiz	Lita
3	Njesia S	Lutfije	Islan	Pasha

0.0.0.0

0.4.13

Lista nr. 10						
Nr.	Nume	Ente/Alteț responsabilă	Fișe DS4	Nr. revizii	Venditori și Kesidlar esențială după de clară judegă subiectelor pe firmă	Asistență
1	Data	Jonuz Ramiz Uta	DS4	9	175/2020	Eliget nga lista e performanșe për të vijuar me procedurë për numënim dëgjim të diversuar